



RELACION TEKNIK

PROJEKTI I NDERTIMIT TE DEPOZITAVE BREGDETARE PER NAFTE DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ NE “ZONEN E PORTOROMANOS”

QARKU DURRES

(Sipas Vendimit nr. 912 datë.11.11.2015)



Subjekti: “KALDAJA”SH.A

Përgatiti për “GBA STUDIO”: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Denisa Kola'.

TIRANE 2017



HYRJE

Per realizimin e projektit te ndertimit dhe shfrytezimit te depozitave bregdetare si dhe bazes mekanike te mirembajtjes se tyre eshte kryer Studimi Mjedisor mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis sipas porosise nga vete subjekti **KALDAJA** sh.a. Aktiviteti i kesaj shoqerie konsiston ne ndertimin e konstruksioneve kryesisht metalike ne fushen e instalimeve, depozitave dhe tregetimit te hidrokarbureve. Me konkretisht kjo shoqeri eshte e paisur me potenciale teknike, teknologjike dhe burime njerezore te specializuara ne sherbime te tilla. Ndryshe nga shume subjekte qe aktualisht kane ndertuar depozita bregdetare ne Parkun Energjitik te Portopalermos Durres subjekti ne fjale ka nje eksperienc dhe kontibut direct ne ndertimin e konstruksioneve te tilla si dhe zoteron nje baze te fuqishme mekanike per ndertimin dhe mirembajtjen e ketyre konstruksioneve. Realizimi i ketij projekti nga pikepamja e vleres se sherbimeve nuk do ti sherbej ngushtesisht aktivitetit te ketij subjekti por ne aspektin e mirembajtjes dhe riparimit te difekteve te mundshme do ti sherbej dhe gjithse subjekteve te tjera te instaluara ne kete park energjitiko industrial. Kontributi i saj ne kete fushe eshte konkrete dhe afatgjate tashme i materjalizuar ne ndertimin e depozitave me kapacitete te konsiderueshme te shoqerive lider ne tregun e hidrokarbureve si Kaspetro sh.a, Anoil sh.a etj. Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastructures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit minerar te prodhimit te mineralit ndertimor gurit gelqerore me kariere mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimine ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Projekti tenton permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit, gjate shfrytezimit te tije , si qender rekreative e social- kulturore.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjitha zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Metoda me e pershtateshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis u pranua ajo e liste – kontrollit, e cila vendos nga njera ane te gjitha burimet e mundeshme te ndikimeve dhe nga ana tjeter bartesit e ndikimeve , si dhe parashikimin e madhesise se ndikimit. Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogjeologjia dhe veçorite kryesore te morfologjise se rajonit . Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe

perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedis eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thellesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera. Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve

- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

a) Qellimi i Projektit

Qellimi i projektit te propozuar eshte ndertimi dhe shfrytezimi i depozitave bregdetare per nafte dhe benzine per furnizimin e tregut te industrise qe perdor keto produktet si lende te pare, qe te perkrah zhvillimin ekonomik te shoqerise dhe te permiresoje gjendjen ekzistuese te lendeve te para si dhe Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin ndertim dhe shfrytezim te depozitave bregdetare per nafte dhe benzine, ne zonen kadastrale 3184 ne fshatin Rinia Durres.

Kjo zone eshte e preferuar per ndertimin e depozitave bregdetare per nafte dhe benzine sepse ndodhet prane portit dhe eshte zone energjitike ne te cilen operojne dhe subjekte te tjera me aktivite te ngjashme me kete ne fjale.

b) Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harten topografike siperfaqja e tokes se kerkuar , kufijt e siperfaqes se kerkuar , te dhenat per perdorimin ekzistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve.





Pamje nga Google Earthe e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti
Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones ne fjale ne sistemin Gauss Kruger

Nr.	E	N
1	4368620.35	4583713.88
2	4368656.92	4583651.49
3	4368459.06	4583534.33
4	4368449.70	4583612.32


Vendi i ndertimit te depozitave, eshte nje terren fushor i cili eshte i vendosur ne pjesen me perendimore te kontureve te Parkut Energjistik dhe Industrial te zones se Portoromanos. Me saktesisht ky shesh ndodhet ne very te shoqerise Global Gas sh.a dhe te nyjes se perbashket teknologjike te linjave te shoqerise qe kane ndertuar depozitat bregdetare per nafte dhe GLN ne kete park energjistik. Konturet e tij pronesore kufizohen si me poshte:
 Ne drejtimin very-jug kufizohet nga konturet e parkut energjistik gjeometrikisht ose nga konturet e emisarit te ujerave qe shoqeron gjeografikisht rrugen nacionale te Portopalermos. Ne drejtim te lindjes konturi i ketij sheshi kufizohet nga rruga qe shkon nga depozitat e shoqerise Mare oil. Ne drejtim te jugut konturi i ketij sheshi ndertimi kufizohet nga prona e shoqerise Global Gas sh.a. Sikurse shihet ne harten e prones apo ne skemen rajonale te kontureve te ketij parku energjistik, konfiguracioni i ketij sheshi ndertimi eshte ne trajten e nje trapeze me baze te gjere ne drejtim te jugut dhe qe ngushtohet ne drejtim te veriut.



Pamje ku tregohet vendi ku do te ndertohen depozitat



Planvendosja e depozitave



Planvendosja e depozitave ne 3D

Relievi i zonës është malor dhe dallohet për karakterin kompleks në përbërje të relievit gjejmë: kurrize malore, pllaja, gropa, fusha karstike si dhe lugina.

c) Gjeografia e topografia e zones

Relievi i zonës ku do të ushtrohet aktiviteti është fushor. Struktura e tij gjeologjike është kryesisht e përbërë nga formacione të zonës. Zona Shkozë-Durrës është pjesë e mbështetjes së ish-kontinentit, në anën jugore. Në jug ngushtohet midis detit Adriatik dhe depozitimit të molasikëve të strukturës Shkallë-Kryemadh, ndërsa në veri vazhdon të zgjerohet midis formacionit mollasik të Currilave në perëndim dhe atyre të Shenavlash-Rreshbullit në lindje. Në afërsi të rajonit është qyteti i Durrësit, i cili është një qendër e rëndësishme dhe qyteti i dytë në Shqipëri për nga numri i popullsisë. Në të ndodhet porti më i madh i vendit, gjithashtu ka dhe një muze të madh plazhesh, të cilët preferohen shumë nga turistët e huaj.

dhe vendas. Krahu perëndimor laget nga deti Adriatik, ndërsa në veri të planshetit kemi derdhjen e lumit Erzen. Terreni në përgjithësi është fushor, me përjashtim të pjesës veriperëndimore që përbëhet nga një varg kodrash siç është ajo e Spitalës me lartësi 182m. Përta i perket bimësisë, në afërsi të bregdetit predominon druri i pishës. Ky rajon ndërtohet nga formacione molasike të Ultësirës Adriatike dhe depozitime kuaternare. Mesiniani (N13m) – formacionet molasike të Mesinianit përhapen në segmentin Durrës – Bishti i Pallës, përgjatë bregdetit adriatik. Veçohen tre pako që nga poshtë lart janë :N13m(b) – ranorë shtresë trashë dhe argjila. Trashësia 350m. N13m(c) – argjila, alevrolite. Trashësia 400m. N13m(d) – argjila, thjerza ranore, gipse (formacioni Mengaj). Trashësia 50 - 400m. Në hartë pakot e mësipërme nuk paraqiten të veçuara. Për segmentin Durrës – Porto Romano hartograhohen së bashku dy pakot e sipërme (N13m(c + d)), ndërsa për segmentin e Bishtit të Pallës hartograhohen së bashku dy pakot e mesme (N13m(b + c)). Plioceni (N2) – shtrihet transgresivisht mbi formacionet e Mesinianit. Rrafshi I transgresioni ndiqet gjithkund nga Durrësi në Porto – Romano dhe në Bishtin e Pallës. Një dalje e Pliocenit zhvishet edhe në pjesën lindore të dy planshetave veriorë. Plioceni ndahet në dy formacione, por në rajonin tonë zhvishet vetëm formacioni i poshtëm: Helmasi (N₂H), i cili ndahet në tre pako, që nga poshtë lart janë : N2H(a) – ranorë, konglomerate dhe argjila,. Konglomeratet dhe ranorët përfaqësojnë bazën e transgresionit të Pliocenit mbi formacionet e Mesinianit. Trashësia 350 – 400m. N2H(b) – argjila, alevrolite, linza ranore. Trashësia 500m. N2H(c) – ranorë, argjila, alevrolite me linza konglomeratesh. Trashësia 400m. Kuaternari (Q) – ka përhapje të gjërë, duke zënë rreth 80% të sipërfaqes së këtij rajoni. Në sipërfaqe zhvishen vetëm depozitime të Holocenit. c, d, p, Qh – Holocen. Koluvione, deluvione, proluvione; argjila, alevrite, rëra, copa. Trashësia 0 – 30m. alQh1 – Holocen i hershëm. Aluvione, argjila, alevrite, rëra, zhavorre. Trashësia rreth 60m. LQh₂ – Holocen i vonshëm. Depozitime lagunore; argjila, alevrite, rëra të imta, mbeturina dhe rrënjë bimësh. Trashësia rreth 50m. AlQh₂ – Holocen i vonshëm. Aluvione, alevrite, argjila, rëra, zhavorre. Trashësia deri 10m DQh₂ – Holocen i vonshëm. Depozitime detare; rëra zhure. Takohen edhe shkrifërime detare.

Te dhena hidrogeologjike

Ne aspektin hidrogeologjik ky shesh karakterizohet nga ujembajtje e vazhueshme, për vetë faktin se sheshi është në kuotën me të ulët, pothuajse në nivele të detit. Niveli i perhershem i ujrave nentokesore këtu është po ai i detit. Kemi të bëjmë me një basen nentokesor pothuajse me ujra të ndenjura. Tendencat e dinamikës së ujrave është nga lindje në perëndim, por levizja është shumë e ngadalte. Në rast hapje themelesh apo kanalesh ujembajtja do të jete e lartë. Ardhja e ujrave nga lindje drejt perëndimit do të shtohet. Sedimentet si ato kenetore po ashtu edhe ato aluviale janë të paqendrueshme, germohen me eskavator lehtësisht.

Te dhenat sizmike

Në pikpamje sizmike rajoni i Durrësit ku ben pjese edhe sheshi i mesiperm është një nder rajonet me të qeta. Gjëndet larg thyerjeve të thella sismotektonike dhe dallohet për faktin që shumë rralle është kapur nga termetet. Sforcimet kryesore maksimale sipas mekanizmit të

vatrave te termeteve te ndodhura ne Shqiperi jane me orjentim nga jugperendimi ne veri lindje me renie ne juglindje.

- d) Pershkrim i procesit ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese perpunuese , sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit**

-kushtet e sheshit te ndertimit

Topografia dhe batimetria

Rajoni i Durresit ofron pamje te pergjitheshme fushore-kodrinore, ku vecohen: sistemi kodrinor i urbanizuar kryesisht me ndertime te ulta dhe ai fushor ne lindje e jug te tij, ku kohet e fundit ndertimet i jane drejtuar lartesisive mbi 10 kate. Ne rastin konkret kemi te bejme me nje terren fushor gjysem mocalor i bonifikuar nga nderhyrja e dores se njeriut por qe ende ne pozicione te caktuara ruan nje kuete deri ne 1 meter nen nivelin e detit. Sistemi kodrinor ngushtohet drejt veriut dhe nderpritet ne zonen e Portoromanos (hidrovori) per tu ringritur perseri pas rreth 2 km. Ne kodrat e Bishtit te Palles, duke formuar keshtu nje gji detar relativisht te ceket. Komunikimi i dikurshem det-lagune u nderpre pas viteve 60', nga veprat bonifikuese dhe sistemi i zones fushore te ish kenetes se Durresit, nepermjet diges mbrojtese te larte 2m qe perben aktualisht edhe trasene e vetme te rruges per ne Bishtin e Palles.



Sikurse shihet ne kete foto nga rruga ngelet traseja kryesore per ndarjen e ambientit detar nga ai toksor nderkohe qe siperfaqja e shesheve te masterplanit te parkut energjistik dhe industrial eshte nen nivelin e detit gje qe krijon siperfaqe te lira uji ne kushtet e motit me lageshti.




Ne te njejten kohe keto pamje jane dhe shprehje e qarte e kontrastit te ambjenteve te lira natyrore dhe atyre te kuadrateve te trajtuara si sheshe teknologjik te sistemuar dhe gjelberuar sipas kondicioneve bashkohore. Ne te gjithe rastet ne projektet e tyre shoqerite qe ndertojne depozita bregdetare ne planin e menaxhimit te siperfaqes se sheshit te ndertimit parashikojne siperfaqet teknologjike dhe ato ndertimore dhe ekologjike. Ne siperfaqet teknologjike perfshihet dhe teresia e platformave te vaskave te sigurise te shtruara dhe rrethuara me perde betony mbi te cilen jane vendosur dhe bazamentet e depozitave. Niveli i vendosjes se platformave te depozitave eshte gati 2 m mbi nivelin e detit gje qe bent e mundur evitimin e permbytjeve te siperfaqeve teknologjike nga shirat intensive dhe prania e ujerave freatik.



Ne kete foto dallohet qarte natyra mocalore e bimesise qe karakterizon kete siperfaqe toke. Pamja e shesheve ku jane ndertuar depozitat bregdetare per nafte, eshte bere me kahje nga perendimi ne drejtim te lindjes duke filluar nga bordi i emisarit kullues qe shkon parallel me

rrugen per ne Portopalermo. Nje nga elementet qe terheq vemendjen ne kete foto eshte dhe prezenca e ujit te emisarit te pergjithshem ne hapesiren gjatesore midis shkurreve i cili deshmon per nivelin e larte te ujerave mbetes qe krijojne siperfaqe te ndotura te shesheve me kushte natyrore Brenda kontureve te masterplanit te parkut industrial dhe energjitik te kesaj zone.



Pamje sipas drejtimit gjatesor te rruges se Portoromanos parallel me te cilen shtrihet emisari shkarkimit te ujerave siperfaqesore te ish kenetes se Duresit. Ne sfond dallohet parku i depozitave te shoqerise Elda sha. Pikerisht ne platformen para ketyre depozitave shtrihet kuadrati i sheshit te depozitave te shoqerise Kaldaja sha.



Pamje tipike e faunes se facies se ceket te pasur me fosile te familjes Gastropoda Kompleksi faunistik i evidentuar ne kete foto nga pikepamja paleogjeografike tregohet se ky mjedis ujqor tashme te terhequr ne drejtim te perendimit. Nje element tjetër tregues per kete mini system ekologjik eshte dhe prezenca e materjaleve dytesor te hedhur nga veprimtaria njerezore.



Sikurse e permendem dhe me siper, terreni ne te cilin do te realizohet ky projekt eshte fushor i perbere kryesisht nga depozitime te shkriфта sir era, surera, suargjila, depozitime llumore etj.

-Pershkrimi i procesit teknologjike

Ky park rezervuaresh qe do te sherbej per depozitimin dhe shperndarjen e karburanteve, kryesisht nafte dhe benzine, perfaqeson nje magazine produktesh te katshme me parametra te stabilizuara ne kushtet e standarteve. Ky stabilitet eshte dinamik sepse me ndryshimin e presionit e te temperatures, ndryshojne pjeserisht vetite fiziko-kimike te karburanteve qe ndodhen ne rezervuaret e ketij objekti. Ky ekuilibër eshte i domosdoshem vecanerisht per produktet volative (ne kete rast benzina), qe ka rritje te ndieshme te presionit te avujve me rritjen e temperatures, qofte edhe ne pak grade. Si e tille per ftohjene rezervuarve gjate muajve te nxehte, parashikohet dushimi me uje te fresket. Depozitimi i karburanteve perben nje proces jo te lehte dhe parashikon mbajtjen e nje sere parametrash rigoroze ne skemen teknologjike, si dhe nje varg masash suplementare per te garantuar nje pune normale ne objekt e pa rreziqe per punen e jeten e personelit.

Ne perberjen e skemes teknologjike hyjne keto sisteme :

1. Sistemi i rezervuarve dhe aksesoret e tyre.
2. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri dhe hidrantet.
3. Sistemi i mbrojtjes se mjedisit e dekoracioni.

4. Sistemi i tubacioneve dhe armaturave te karburantit, tubacionet e ujit teknologjik ne separator.
5. Sistemi i matjes e kontrollit automatik te pajisjeve e makinerive, sinjaleve te alarmit si dhe levizjeve te lengjeve ne tubacion.
6. Sistemi i estakadave per ngarkimin e autocisternave, pompat dhe armaturat perkatese.
7. Sistemi i ndarjes se ujit nga dekantimet e rezervuarve.
8. Sistemi i ujerave siperfaqesor (te shiut, bores) dhe drenazhimet.

1. Sistemi i rezervuarve

Rezervuaret jane ene cilindrike vertikale, te ndertuara me flete celiku te markes e spesorit te caktuar sipas llogaritjeve teknike, te bashkuara me disa breza unazash te salsuara me elektroda te markes qe i pershtatet llamarines se celikut. Ndertimi i tyre realizohet sipas nje teknologjie europiane dhe te vendit per prodhimin e tyre, si dhe kushtet teknike te montimit te rezervuarve. Ne rastin konkret rezervuaret e karburantit qe parashikohen te ndertohen nga kjo shoqeri, i plotesojne te gjitha kushtet e standarteve perendimore. Gjithcka qe do te vendoset ne kete objekt eshte parashikuar te jete teper e sigurte per vete natyren e punes qe do te kryeje. Duke filluar nga rezervuaret, tubacionet, armaturat, impianti i MNZ, salla e pompave, estakadat do te jene te sigurta, ndersa makinerite, fjala e fundit e teknikes. Perdorimi i llamarines cilesore per rezervuaret do ti mundesoje jetegjatesi deri ne 25 vjet, kjo sepse materialet qe do te perdoren per ndertimin e objektit do te jene te standarteve europiane.

Per **tubat** mund te perdoren nje nga keto standaret :

ASTM	A106-A
DIN	17175-St.35.8
BS	3602-23
DIN	17007-EI 0305

Per **llamarinat** :

ASTM	A285-B
DIN	17175-St.37.2
JIS	SB 42

Per **saracineskat** :

ASTM	A216 ECB
DIN	2663

Per **flanxhat, brrylat** :

ASTM	A 181-1
------	---------

Te gjitha materialet qe paraqiten ne tabelat e vizatimeve jane perzgjedhur duke i vendosur sipas standartit dhe llojit te materialit.

Per shembull : tubot e çelikut 20 do te kete perberje :

C – 0.18-2.1% ; Mn- 3.35-0.65% ; Si- 0.17-0.37% dhe P 0.05 % ; Cr – 0.15 – 0.25% ; Ni 0.01% ; Al – 0.15 – 0.20%.

Rezervuaret e gazoilut do te jene te konstruksionit standart normal pra, rezervuare cilindrike metalike vertikal, mbitokesor kurse ata te benzines do te jene te sistemit te vecante me kapak notues mbitokesor. Kjo per arsyen e vetme, uljen ne maksimum te humbjeve gjate manovrimeve per mbushjen e zbrazjen e rezervuareve. Kapaku notues shoqeron ne menyre te vazhdueshme nivelin e lengut ne rezervuar e nuk le hapsire per avullime te shkalles se larte. Me ngritjen e nivelit te benzines ne rezervuar, ngrihet edhe kapaku notues dhe e kunderta. Edhe keta rezervuare si ata standarte, kane bokaporta kontrolli, drite (hyrje), pajisje matese valvual sigurie e frymemarrje, te vendosura mbi kapak. Ne rastin kur rezervuari i benzines eshte ne procesin e mbushjes, per ngritjen e kapakut notues eshte e domosdoshme te merren parasysh pesha e kapakut me gjithë pajisjet, si dhe prurjet per shkak te rreshjeve atmosferike (shi, bore) si dhe forcat e ferkimit midis kapakut notues e pareteve te rezervuarit. Prandaj gjate llogaritjes se forces ngritese merret parasysh mosbarazimi :

$(G_k + C_o) (1+F) + F^* / h$ ku :

G_k - pesha e kapakut notues me gjithë pajisjet

C_o – pesha per shkak te prurjeve atmosferike

F – koeficienti i ferkimit midis kapakut notues e korpusit te rezervuarit

h – madhesia (lartesia) e zhytjes se kapakut notues ne produktin e naftes

- fusha specifike e produktit te naftes ne rezervuar

Sistemi i rezervuarit me kapak notues eshte mjaft i komplikuar ne pergatitje po ashtu ka dhe nje kosto te larte prodhimi, por qe kompesohet me zvogelimin rreth 30 here te humbjeve per shkak te avullimit.

2. Sistemi i MNZ

Meqenese te tilla objekte jane te shkalles se larte per rrezikun nga zjarri do te ndertohet nje sistem i plote i impiantit te MNZ me aksesoret perkates. Ne kete sistem perfshihen 1 rezervuare uji 1540 m^3 , 2 pompa uji me kapacitet $140 \text{ m}^3/\text{ore}$ secila, pajisje per pergatitjen e shkumes, tubacione qe cojne uje dhe shkume ne gjeneratoren dhe dhomat e shkumes ne rezervuar, hidrantet si dhe aksesoret e tyre. Ky sistem do te jete i pavarur sepse ka rezerve uji 1540 m^3 , pusi i ujit si dhe nje linje rezerve nga linja kryesore e ujit industrial te qytetit. Sistemi zjarrfikes do te jete ne forme unaze ku ne cdo 40 m linear do te vendosen minitore shkume/uji. Eshte parashikuar nje automatizem i dergimit te shkumes ne rezervuar. Ne te gjithë territorin ku eshte e domosdoshme, do te vendosen tabela paralajmeruese per MNZ, sigurimin teknik e mbrojtjen ne pune.

3. Sistemi i mbrojtjes se mjedisit nga ndotja dhe dokoracioni

Ane pozitive e sheshit ku do te ndertohet ky objekt eshte se rreth tij nuk ka ambjente banimi, familjare. Megjithate, duke u mbeshtetur ne legjislacionin e sotem te Republikes se Shqiperise per mbrojtjen e mjedisit, perparesi do ti jepet mbrojtjes se mjedisit nga ndotja. Per te siguruar

nje mjedis te paster e pa problem per personelin e sherbimit, si dhe per objekte afer parkut te rezervuareve, eshte parashikuar nje sistem kanalizimesh, tubacionesh te cilat ne bashkeveprim do te orientojne ujerat teknologjike, ujerat natyrale dhe ujerat e shkarkimit te rezervuareve. Ne projekt eshte parashikuar nje sistem grumbullimi, ne nje rezervuar nentokesor betonarme me kapacitet 15 m³ me tre ndarje. Ne ndarjen e pare do te behet grumbullimi dhe dekantimi i nje pjese te ujit dhe te mbeturinave mekanike. Ne ndarjen e dyte do te kryhet grumbullimi i lendeve karbohidrate per efekt te ndryshimit te peshave specifike. Kjo sasi e grumbulluar, do te largohet periodikisht nepermjet nje pompe zhytесе per tek autobotet qe grumbullojne mbetjet. Nga ndarja e trete, largohet uji i paster per ne puseten kryesore te drenazhimit te objektit. Ujerat pasi te kontrollohen nga permbajtja e karburanteve, do te shkarkohen ne destinacionin e caktuar dhe ne marreveshje me ARM te qarkut Durres. Masave parandaluese per mbrojtjen e mjedisit do ti shtohen sistemi i vendeve te lira, duke i punar e kthyer ne lulishte e gjelberim me peme dekorative, duke krijuar nje ambient te kulturuar. Parashikohen edhe punetore ne mbajtjen e ambienteve gjithemone te blerta. Ne cdo rezervuar do te vendosen kllapushka per mbrojtjen e mjedisit dhe per te mos humbur produkti, si dhe dhjete thase me rere.

4. Sistemi i tubacioneve dhe i armaturave

Ne kete sistem perfshihen te gjitha tubacionet dhe armaturat, te cilat realizojne te gjitha levizjen e lengjeve, duke perfshire karburantet, ujerat teknologjike (shkarkimet), shkumen zjarrefikese per rezervuaret e karburanteve. Ne keto tubacione, ne vende te caktuara do te vendosen saracineska e valvula per realizimin normal te levizjes se lengjeve. Tubacionet dhe armaturat zgjidhen ne funksion te lengjeve qe levizin ne tubacion, duke ju pershtatur standarteve europiane, qe do te pasqyrohen ne tabelat perkatese, bashkengjitur materialit qe do te hartohet nga realizimi i projektit te zbatimit.

5. Sistemimi i matjes e kontrollit automatik

Sistemi i matjes e kontrollit automatik te pajisjeve e makinerive, sinjalistikes si dhe te levizjes se lengjeve nga rezervuari ne tubacione e anasjelltas, do te sherbeje per te ditur ne cdo kohe gjendjen e karburanteve ne rezervuare si dhe sasine e hyrjes e daljes se tyre, te cilat do te pasqyrohen ne aparatet mates e te kontrollit, qe do te instalohen ne nje salle operative, e cila do te mbikeqyret 24 ore rresht nga personeli i sherbimit te objektit. Aparatura do te jete me sistem modern elektronik, per te pasqyruar ne cdo kohe te dhenat e duhura per cdo operacion pune qe kryhet ne objekt. Ato mbikeqyren e merren nga personat pergjegjes.

6. Sistemimi i estakadave per ngarkim

Epiqendra ku do te kryhet volumi i punes ne objekt, jane estakadat e ngarkimit gjithesej 2. Ketij sistemi i bashkengjitet salla e pompave, nepermjet te cilave realizohet ngarkimi i karburanteve ne cisterna. Estakadat kane platformen ku do te kryhet nga ana e personelit ngarkimi i cisternave. Ne platforme dalin grykat e tubacioneve ku vendosen krahet e ngarkimit si dhe aparatet matese te sasise se lengut qe hyjne ne cisterne. Ketu duhet mbajtur parasysh profesionalizmi i punonjesve. Ne kete sektor do te vendosen mjete zjarrefikese te levizshme si

fikese me rrota, fikese te vendosura ne kolonat e estakades si fikese CO₂ rere fosile etj. Vendoset linje uji per pastrimin e territorit e salles se pompave. Ne te gjitha pikat do te instalohen shirita tokezimi sipas rregullores se sigurimit teknik e mbrojtjes ne pune, kjo per te shkarkuar tensionet elektrostatische qe lindin gjate ngarkimit te karburantit ne cisterne. Do te kete edhe linje dushimi ne estakaden e benzines, gjate stines se veres per ftohjen e cisternave. Keto pasqyrimet perbejne gjithë skemen teknologjike te objektit, te cilat do te jepen me me hollesi si bashkeshoqerues te projektit te zbatimit.

Ne projekt do te perfshihen edhe materiale te tjera te ndertimit, elektrikut qe do te garantojne nje pune normale ne objekt. Puna normale ne objekt realizohet gjithashtu me ndihmen e rregulloreve te shfrytezimit te objektit, te sigurimit teknik, MNZ e mbrojtjes se mjedisit. Ne ndihme te zbatimit te ketyre rregulloreve do te jene edhe tabelat parandaluese per ndergjegjesimin e personelit dhe te atyre qe do te hyjne ne objekt. Tabelat do te vendosen ne vende ku rreziku per jeten e njeriut eshte me e pranishme, po ashtu edhe tabela per qarkullimin e vend qendrimit te automjeteve. Tabelat do te jene te permasave standarte e te vendosura ne vende te sigurta e me pamje te plote. Do te parashikohet qe ne organike te vendoset nje person i kualifikuar me detyren e inspektorit te sigurimit teknik i MNZ. Ky do te regjistroje cdo levizje te gabuar, manovrim te gabuar, gjendjen e gadishmerise se mjeteve te MNZ dhe te nderlidhjes telefonike ose te nderlidhjes me radio. Pamjet gjithë ngjyresh e sipas standarteve do ti jepet objektit pamje te bukur.

7. Sistemimi i ujerave

Teresine e ujerave qe do te rezultojne gjate shfrytezimit te parkut te rezervuareve, do ta ndajme ne 2 grupe :

1. Gjithë ujerat natyrale si shiu, bora dhe ujerat e hidranteve ose rrjedhje te ujit per shkak te ftohjes se pajisjeve (rezervuareve, cisternave) ne periudhen e veres do te kene drejtimin e tyre te caktuar, bashke me ujerat higjeno-sanitare dhe ato te larjes se siperfaqeve te territorit qe nuk kane te bejne me karburante, benzine e gazoil. Keto ujera nepermjet drenazhimeve e kanalizimeve te mbyllura, orientohen ne drejtim te kanalit kryesor qe ndodhet jashte parkut te rezervuareve, natyrishte pasi te jete marre miratimi i organeve kompetente ose monitorohen si nga vete personeli i parkut te rezervuareve apo inspektoret e ARM.
2. Keto kanalizime luajne edhe rolin per grumbullimin dhe shkarkimin e ujerave qe rezultojne pas kolaudit te pajisjeve, pompave, hidranteve te sistemit zjarrefikes etj. Ose gjate pravave per pastrimin e tubacioneve e ujerave teknologjike.

8. Sistemi i ujerave teknologjik

Ne kete grup hyjne te gjithë ujerat qe rezultojne nga deklarimet e rezervuareve te larjes se salles se pompave, estakadave te ngarkimit te karburanteve si dhe shkarkimet e separatoreve te cdo grupi rezervash- keto ujera teknologjike jane faktori kryesor qe mund te ndikoj ne ndotjen e mjedisit si Brenda parkut te rezervuareve ashtu edhe te kanalit kryesor ku ata do te orientohen. Prandaj ne projekt eshte parashikuar nje system i plote kanalizimesh, drenazhimesh qe orientohen vec ujerave siperfaqesore ne derdhje te caktuar

per ne kanal in kryesor. Cdo shkar, kim i ketyre ujerave do te kryhet vetem ateher kur analiza per pranine e gjurmes se karburanteve te jete Brenda normave te lejuara dhe te percaktuara nga organet monitoruese te Ministrise se Mjedisit sic eshte ARM e Qarkut Durres qe cdo kontroll e kryen me inspektoret e saj. Kujdes i vecante duhet te tregohet sidomos gjate ndonje avarie te mundshme kur behet fjale per carje rezervuari, tubacioni ose saracineske, sidomos ne periudhen e dimrit. Ne project edhe ne keto raste jane parashikuar masa te shpejta per izolimin e rrjedhjeve massive te pakontrolluara.


Kontrolli i punimeve te ndertim-montimit dhe marrja ne dorezim e objektit sipas skemes teknologjike.

Per rakordim te punimeve te ndertim-montimit midis pales zbatuese dhe asaj qe do te marre ne dorezim objektin duhet te emerohet nje supervisor, i cili ndjek punimet deri ne fund, kur te kete mbaruar gjithë pjeset e objektit ne baze te skemes se zbatimit. Ne te gjitha rastet, supervizori duhet te kontrolloj me imtesi zbatimin e standarteve qe u paraqiten me larte. Pasi te sigurohet per kete mund te filloj procedure e dorezimit. Per te filluar procedurat e dorezimit te objektit, ngrihet nga te 2 palet nje grup per marrjen ne dorezim te Parkut te Rezervuareve. Puna duhet te filloj nga kontrolli rigoroz i projektit si ne anen ndertimore, elektrike, teknologjike, duhet bere dhe verejtjet perkatese. Pas kesaj do te kalohet ne fazen e presimit e proves per te gjitha pajisjet, makinerite, tubacionet, armaturat e aparatet matese e te kontrollit.

Pershkrimi teknologjik i depozitave

Perberja e depozitave sikurse duket dhe ne grafikun shoqerues te ketij studimi, nga pikepamja e kapaciteteve do te jene si me poshte:

- 4 depozita nafte me nga 5000 m³ secila
- 1 depozite nafte 3000 m³
- 2 depozita nafte me 1000 m³ secila
- 1 depozite benzene me 3000 m³
- 1 depozite benzene me 1000 m³
- 1 depozite vajguri me 1000 m³
- 1 depozite uji me 1000 m³ per sistemin e mbrojtjes nga zjarri
- 1 baze riparimi dhe ndertimi depozitash me siperfaqe totale 3500 m³ dhe siperfaqe te objektit ku do te kryhet ky aktivitet eshte 544 m² i cili do te jete i ndertuar me konstruksion metalik.




Pamje balllore e depozitave


Natyra e depozitave do te jete kryesisht me cati notuese vecanerisht per depozitat e benzines te cilat dominohen nga ne intesitet i larte volativ dhe presence te vazhdueshme te fazes se gazte. Nga pikepamja e kushteve dhe normave teknike ky impjant do te ndertohet sipas standarteve kombetare dhe ne perputhje me normat e BE-se

Estakada e perpunimit te automjeteve dhe sistemi i MNZ-se

Kjo estakade do te kete kater grupe pompash pra nje system te dubluar pompash per cdo linje fluidi te elevatoreve qe do te perpunojne ngarkesat ne autocisterna. Secila prej linjave dhe vet impjanti i depozitave jane te kompletuar me system dushimi dhe sensor per parandalimin e ngjarjeve te jashtezakonshme. Bashkeshoqeruar me atrecaturen teknologjike te depozitimit dhe qarkullimit te fluideve, impjanti do te jete i pajisur me sistemin MNZ-se te depozites se shkumes dhe pompes se injektimit te perzjerjes per izolimin dhe shuarjen e zjarreve.



Pamje nga estakada



Pamje e autocisternave

Objekti ndertimor administrative dhe sherbimeve civile do te berbehet kryesisht nga godina e administrates dhe objektet sanitare si dhe sherbimit te MCR-se. objekti kryesor ndertimor ne kete kompleks teknologjik eshte godina administrative e cila parashikohet te jete ne pozicion

ballor ne raport me sheshin teknologjik nje kateshe me ndarje ne hapsira funksionale per te gjithë proceset administrative dhe me hapsira te konsiderueshme drite te konturuar nga konstruksione vetratash me perde xhami. Me te rendesishme nga pikepamja ndertimore dhe gjeologo-inxhinierike ngelen bazamentet e depozitave te cilat mund te jene patformike ose unazore me siperfaqe solide te shtresave inerte te ruluara. Po keshtu kujdes ne kompozim dhe konstruksion kerkojne vaskat e sigurise me konstruksion betoni te armuar. Keto vaska parandalojne perhapjen e ndotjes se hidrokarbureve te lenget dhe per pasoje perbejne dhe nje nga kushtet kryesore qe garantojne funksionimin e projektit. Volume i tyre llogaritet ne funksion te kapacitetit te depozites me te madhe qe perfshihet ne ted he me kusht teknik duhet te jete jo me i vogel se gjysma e ketij volume. Ne teknologjite modern ky kondicion ndryshon ne rastin e ndertimit te depozitave vertikale cilindrike kur ato ndertohen me dy pale parete, pra me hapsire unazore sigurie.



Pamje e godines se administrates

- Sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit
- Sasite e lendeve te para

Lenda e pare eshte uje, nafte dhe benzine e ardhur nga importi. Sasia e ketyre lendeve te para eshte ne varesi te kapacitetit te depozitave pra ne kete rast kemi kater depozita nafte me kapacitet:

$$4 * 5000 \text{ m}^3 = 20000 \text{ m}^3$$

$$1 * 3000 \text{ m}^3 = 3000 \text{ m}^3$$

$$2 * 1000 = 2000 \text{ m}^3 \text{ pra sasia e naftes eshte } 20000 + 3000 + 2000 = 25000 \text{ m}^3$$

Ndersa depozita benzene jane dy te cilat kane kapacitetet perkatesisht:

$$1 * 3000 \text{m}^3 = 3000 \text{m}^3$$

$$1 * 1000 \text{m}^3 = 1000 \text{m}^3 \text{ pra sasia e benzines do te jete } 3000 + 1000 = 4000 \text{ m}^3$$

Depozita e vajgurit

$$1 * 1000 = 1000 \text{m}^3$$

Depozita e ujit eshte 1 dhe ka kapacitet 1000 m³

- e) **Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja**

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik

Stacioni i depozitimit te karburanteve te lengeta nafte dhe nenprodukteve te saj punon me energji elektrike nga rrjeti 20/0.4 kV dhe si burim energjie per emergjenca teknologjike dhe siguri teknike, perdor enrgjin e perfituar nga desel gjenerator me fuqi 250kVA. Burimi nga merret energjia elektrike eshte nenstacioni ne Spital 110/20 kV. Nga nenstacioni elektrik i Spitalles deri ne zonen industrial dhe konkretisht ne gabinen e distributorit te kompanise "KALDAJA" sh.a energjia elektrike transmetohet me lidhje ajerore e cila eshte private ne pronesi te KALDAJA sha. Konsumi i energjise elektrike do te jete variable dhe do te varet nga ritmi i punes me fuqi motorrike te pompave te naftes, ndricimit dhe kondicionimit. Sipas kapaciteteve dhe nevojes per ndricim konsumi i energjise elektrike mendohet te shkoje nga 800-1100 kW ne muaj.

Furnizimin me uje

Stacioni i depozitave nuk perdor uje nga rrjeti i shperndarjes se ujesjellesit por perdor rrjetin e vete te furnizimit me uje nga pusi i vet privat i cili eshte ne distance 100-150 m nga sistemi i depozitave. Nepermjet pompes se zhytur ne pus uji nepermjet tubacioneve PVC te shtrira nen toke, dergohet ne depoziten e ujit dhe nga ku me pas shperndahet sipas nevojave ne rrjetin sanitar, teknologjik dhe ai qe sherben per gadishmerine e nevojave te MNZ. Konsumi i ujit pavaresisht qe do te jete burim privat do te varet nga nevojat e perdorimit sanitary, nga nevojat e perdorimit teknologjik, ftohje dhe larje e shesheve sipas rasteve kjo me shume do te jete ne stinen e veres. Nevojat per perdorim uji do te shkojne nga 10 000-15000 litra ne muaj.

Zhurmat

Burimi kumuluar i zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte **180 dB**. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacinin me poshtem:

$$L = 10 \lg (I_1/I_0) \text{ ku}$$

Ku:

L - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate.

I₁ - Intensiteti akustik izhurmave te kumuluar.

I₀ - Intensiteti akustik i references.

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Analiza e frekuences se zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000 Hz, e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut. Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve, mbetje toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme. Teknologjia e shfrytezimit te aktivitetit nuk parashikon perdorimin e ujit vetem ne strinen e veres do te perdoret uji per ftohjen e depozitave te benzines. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones pastaj rrjedhja e metejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre.

- f) Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundeshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe faza e planifikuar per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit**

Faza e ndertimit

Projekti eshte ne fazat e para duke pergatitur dokumentacionet per tu paisur me lejet perkatese qe te filloj nga puna.

Shoqeria KALDAJA sha do te operoi ne fushen e tregetimit te hidrokarbureve te lengeta. Ndertimi dhe funksionimi teknologjik konsiston ne ndertimin e 8 depozitave 4 do te jene depozita nafte 3 depozita benzene dhe 1 depozite uji.

Faza e funksionimit

Kaldaja sha do te operoi ne fushen e tregetimit te hidrokarbureve sic e kemi permendur edhe me larte. Funksionimi teknologjik konsiston ne mbushjen e depozitave, ruajtjen e produkteve ne kushte optimal dhe ne ngarkimin e autoboteve qe sherbejne per evadimin e produktit te shitur.

Kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundeshme te perfundimit te funksionimit te projektit, Përcaktimi i kapacitetit prodhues

Nga kompania mendohet se periudha e ndertimit te ketyre depozitave do te jete 2-3 vjet. Persa i perket kokezgjatjes se funksionimit shoqeria KALDAJA mendon te operoi ne kete

fushe dera sat a shikoj te arsyeshme. Sic e kemi permendur edhe me larte do te jene 11 depozita 7 prej te cilave do te jene depozita naftje prej te cilave 4 do te kene kapacitet perkatesisht 5000 m^3 secila, 1 depozite me kapacitet 3000 m^3 dhe 1 depozite me kapacitet 1000 m^3 . Do te jete 2 depozita benzene nga te cilat 1 do te jene me kapacitete 3000 m^3 dhe 1 me kapacitet 1000 m^3 . Do te jete 1 depozite vajguri me kapacitet 1000 m^3 . Gjithashtu do te jete dhe 1 depozite uji me kapacitet 1000 m^3 per sistemin e mbrojtjes nga zjarri.

g) Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projekti

Përshkrimi i objekteve ndihmese

- a) Jane planifikuar sistemime për sheshet e ndërtimit te objekteve sipërfaqësore. Sepse objekti nuk eshte ekzistues dhe nuk ka strukture te ngritur.
- b) Do te ndertohet nje godine1 kateshe e cila do te sherbeje si zyra dhe ambjente te tjera funksionale per te gjithë proceset administrative dhe me hapsira te konsiderueshme drite te konturuar nga konstruksione vetratash me perde xhami.

h) lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji)

Lenda e qe do te perdoret per ndertimin e depozitave eshte llamarine e lloit **Ç20**, saracineskat do te jene te llojit **Ç350**. Depozitat do te kene keto karakteristika teknike:

- Kufiri i qendryshmerise 4700 kg/cm^3
- Kufiri i rrjedhshmerise 3200 kg/cm^3
- Zgjatimi (AS) 26%
- Viskoiziteti dinamik 11 kg/cm^2

Gjithashtu do te perdoret dhe beton per bazamentet e depozitave dhe materilae ndertimi per ndertimin e godines qe do te perdoret per zyra e ambjente te tjera sherbimi.

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren jane:

- Naftje dhe Vajra lubrifikant per automjetet
- Uje
- Energjia elektrike per ndricim

j)Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persa i takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret

Zgjedhja e menyres se shfrytezimit te kasaj zone per ndertimin e depozitave eshte bere pasi kjo zone eshte nje zone ne te cilen dhe kompani te tjera operojne ne kete fushe dhe ka aksesin e duhur persa i perket transportit nga rruge detare.

k) Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre

Ky aktivitet eshte aktivitet depozitimi i naftes dhe benzines t i cili konsiston ne depozitim e karburanteve te lengshem. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pikat e furnizimit me karburant.

Lendet e para ndihmese te konsumuara per ndertimin e depozitave jane:

- Fuel Oil, nafta
- Vajrat lubrifikante
- Uje
- Energjia elektrike per ndricim

l)Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.

Zhvillimi i projektit nuk kerkon ndertimin e kampeve per qendrimin e punetoreve gjate kohes se ndertimit dhe shfrytezimit sepse numri i te punesuarve nuk eshte aq i madh sa per te ndertuar keto kampe per fjetje apo mensa sherbimi dhe gjithashtu te punesuarit do te jene nga zona perreth aktivitetit.

m)Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

Subjekti ne fjale nuk disponon Leje Mjedisi tani po ndjek procedurat per tu paisur me te si ne kete rast qe subjekti KALDAJA sha kerkon te paiset me Vendim per VNM Paraprake per ndertimin e depozitave bregdetare per nafte dhe nenprodukteve te saj.

